



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 6 qershor 2024
Nr. ref.: RK 2444/24

AKTVENDIM PËR PAPARANUESHMËRI

në

rastin nr. KI197/22

Parashtrues

Afërdita Gjonbalaj - Stublla

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev. nr. 340/2022 të 13 shtatorit
2022 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Afërdita Gjonbalaj - Stublla me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesja e kërkesës), e cila përfaqësohet nga Skënder Musa, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin [Rev.nr.340/2022] e 13 shtatorit 2022 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në ndërlidhje me Aktvendimin [Ac.nr.8041/2021] e 31 majit 2022 të Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimin [C.nr.3730/2018] e 18 nëntorit 2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, me të cilin parashtruesja e kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të saj të garantuara me nenet: 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksiioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-21 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur, e cila ka shfuqizuar Rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese nr. 01/2018. Lidhur me këtë, konform Rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 12 dhjetor 2022, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën në postë, e cila në Gjykatë arriti dhe u regjistrua më 14 dhjetor 2022.
7. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
8. Më 20 dhjetor 2022, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR.KI197/22 caktoi gjyqtarin Safet Hoxha, gjyqtar raportues dhe me Vendimin KSH.KI197/22 caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, në përbërje të gjyqtarëve: Selvete Gerxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Radomir Laban dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
9. Më 23 janar 2023, Gjykata, për regjistrimin e kërkesës, njoftoi parashtruesen e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.
10. Më 14 nëntor 2023, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që t deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve të rastit

11. Kërkesa ka të bëjë me një kontest civil, respektivisht kontest nga marrëdhënia e punës në mes të parashtrueses së kërkesës dhe Bankës për Biznes, dega në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: punëdhënësi). Parashtruesja e kërkesës me këtë të fundit kishte lidhur kontratën [nr. 1190] e punës, më 3 korrik 2013 për pozitën e Drejtoreshës së degës së Prishtinës, pozitë të cilën e kishte ushtruar deri më 30 shtator 2013.
12. Më 18 shtator 2013, punëdhënësi nëpërmjet njoftimit nr. 1641 informoi parashtruesen e kërkesës se kontrata e saj e punës i skadon më 30 shtator 2013 dhe se për shkak të rrethanave të krijuara në këtë bankë nuk do i vazhdohet kontrata e punës, respektivisht marrëdhënia e punës me punëdhënësin i shkëputet.
13. Më 10 tetor 2013, parashtruesja e kërkesës parashtrroi padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme Gjykata Themelore), kundër njoftimit [nr. 1641] të punëdhënësit për kthim në vendin e punës, duke pretenduar në shkelje të dispozitave që rregullojnë marrëdhënien e punës.
14. Më 30 tetor 2013, parashtruesja e kërkesës parashtrroi ankesë pranë Komisionit për Ankesa të Bordit drejtues të punëdhënësit, kundër njoftimit [nr. 1641] për mos vazhdimin e kontratës së punës.
15. Më 5 janar 2016, Gjykata Themelore me Aktgjykimin C.nr.3391/2013, (i) aprovoi padinë e parashtrueses së kërkesës për anulimin e njoftimit/vendimit të 18 shtatorit 2013 të punëdhënësit, për mos vazhdimin e kontratës së punës dhe (ii) detyroi këtë të fundit që të njejtën ta kthejë në vendin e mëparshëm të punës, si dhe t'ia kompensojë të ardhurat personale, për periudhën kohore prej 1 nëntorit 2013, deri më 20 korrik 2015, në shumën e përgjithshme prej 22.658,74 Euro, përfshirë kamatën ligjore prej 10 tetorit 2013, deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumën prej 1.384,00 Euro.
16. Punëdhënësi, në afat ligjor, parashtrroi ankesë në Gjykatën Apelit, ndaj Aktgjykimi të 5 janarit 2016 të Gjykatës Themelore, me pretendimin se padia e parashtrueses së kërkesës është e parakohshme.
17. Më 9 nëntor 2018, Gjykata e Apelit me Aktvendimit CA.nr.1322/2016, (1) aprovoi ankesën e punëdhënësit dhe (ii) prishi Aktgjykimin e 5 janarit 2016 të Gjykatës Themelore, duke e kthyer lëndën në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Me këtë rast Gjykata e Apelit ka konsideruar që *“gjykata e shkallës së parë nuk i ka sqaruar në mënyrë të duhur dhe krejtësisht të qartë nuk e ka eliminuar dilemën nëse padia u paraqit në gjykatë para së paditësjë t’i drejtohet organeve të paditurës dhe të shteronte mjetet e brendshme juridike...”*.
18. Më 18 nëntor 2019, Gjykata Themelore, nxori Aktvendimin C.nr.3730/18, nëpërmjet të cilit hedhë poshtë, si të parakohshme padinë e parashtrueses së kërkesës. Në aktvendimin e saj, Gjykata Themelore, arsyetoi se *“...paditësi ka pasur të drejtë ligjore që në mënyrë të lirshme të ushtrojë mjetet juridikë, qoftë brenda të paditurës, qoftë edhe në rrugë gjyqësore (nëse nuk kishte marrë përgjigje nga e paditura), mirëpo përdorimi i këtyre mjeteve juridikë është dashur të bëhet brenda afateve ligjore të përcaktuara. Andaj, mos shfrytëzimi i këtyre mjeteve juridikë, brenda afateve të caktuara (afate prekluzive), ka si pasojë edhe humbjen të drejtës për mbrojtje gjyqësore dhe jo për shkak se kjo e drejtë i është mohuar paditësit, por për shkak se ky i fundit ka dështuar që më kohë t’i shfrytëzoj këto mjete juridikë të cilat i ka pasur në dispozicion ...”*

19. Më 29 nëntor 2019, parashtruesja e kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit, ndaj Aktgjykimit të 18 nëntorit 2019 të Gjykatës Themelore, për shkak të (i) vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, (ii) aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe (ii) aplikimit të gabuar të dispozitave të procedurës kontestimore, duke kërkuar aprovimin e ankesës në tërësi dhe anulimin e aktvendimit të goditur me ankesë si jologjor.
20. Më 31 maj 2022, Gjykata e Apelit, me Aktvendimin AC.nr.8041/21, refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtrueses së kërkesës, dhe konfirmoi Aktvendimin e 18 nëntorit 2019 të Gjykatës Themelore. Në arsyetimin e aktvendimit të saj, Gjykata e Apelit, konsideroi se, *“Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas udhëzimeve të gjykatës së apelit, ka vërtetuar faktin se padia është ushtruar në gjykatën e shkallës së parë, para se paditësja t’i drejtohet organit përkatës të së paditurës, dhe t’i shfrytëzojë mjetet e brendshme juridike, e sidomos ku paditësja ka pasur të autorizuar avokatin e saj për përfaqësim nëpër të gjitha institucionet e Kosovës, që nga dt. 03.10.2013, ashtu që gjykata e shkallës së parë është udhëzuar nga gjykata e Apelit të vërtetoj afatshmërnë e padisë, dhe në procedurën e rigjykitimit ka vërtetuar me të drejtë se padia e paditëses është e parakohshme.”*
21. Më 7 korrik 2022, parashtruesja e kërkesës parashtrroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, ndaj Aktvendimit të 31 majit 2022 të Gjykatës së Apelit, për shkak të (i) aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe (ii) aplikimit të gabuar të dispozitave të procedurës kontestimore, me propozimin që Gjykata Supreme të aprovojë kërkesën për revizion dhe të ndryshojë aktvendimet e instancave më të ulëta.
22. Më 13 shtator 2022, Gjykata Supreme me Aktgjykimin e kontestuar Rev. nr. 340/2022, refuzoi, si të pathemeltë, kërkesën për revizion të parashtrueses së kërkesës, me arsyetimin se gjykatat e instancës më të ulët kanë zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat e procedurës kontestimore dhe kanë aplikuar në mënyrë korrekte të drejtën materiale, kur kanë gjetur se padia e parashtrueses së kërkesës është e parakohshme.

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

23. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, sikundër dhe aktvendimet e gjykatave më të ulëta shkelin të drejtat e saj të garantuara me nenet: 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

i. Pretendimet për sheqeje të nenit 31 të Kushtetutës

24. Parashtruesja e kërkesës pretendon se e drejta për gjykim të drejtë i është shkelur, sepse të tri instancat gjyqësore nuk morën për bazë nenin 144 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), për ti siguruar asaj mbrojtje gjyqësore të të drejtave, por ato vetëm u mjaftuan me faktin se padia ishte e parakohshme, duke mos vërtetuar faktin se e paditura nuk e kishte njoftuar atë sipas ligjit të punës, përkatësisht njoftimi për shkëputjen e marrëdhënies së punës nuk kishte këshillë juridike, dhe e tërë kjo është bërë me qëllim që t’i pamundësohet mbrojtja e të drejtave të saj të garantuara me Kushtetutë.
25. Tutje, parashtruesja e kërkesës thekson se ankesën kundër njoftimit [nr. 1641] të punëdhënësit e ka ushtruar më 30 tetor 2013, nga i cili asnjëherë nuk ka marrë përgjigje. Në ndërkohë padinë për kthim në vendin e punës e kishte parashtruar më 10 tetor 2013, duke pas parasysh që njoftimi [nr. 1641] i 18 shtatorit 2013 nuk përmbante këshillë juridike për mjet juridik, duke shtuar tutje se gjykatat sipas nenit 144 të LPK, kanë qenë të obliguara të shqyrtojnë meritorisht çështjen, e jo ta hedhin padinë si të

parakohshme. Ky fakt sipas saj mund të vërehet kur analizohet fakti se ajo, më 30 tetor 2013 e ka paraqitur ankesën kundër njoftimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, dhe nga kjo datë kanë kaluar më shumë se 15 ditë, dhe nuk kishte marrë përgjigje nga punëdhënësi. Në këtë kontekst, parashtruesja pretendon se i ka shterur mjetet juridike të brendshme dhe se padia e saj është bërë e realizueshme para përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë, përkatësisht para 17 dhjetorit 2016, në pajtim me Ligjin e punës dhe nenin 144 të LPK-së. Për më tepër parashtruesja e kërkesës thekson se gjykatave u është dashur 10 vite që ta hedhin padinë si të parakohshme, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 391, pikën f të LPK-së.

ii. *Pretendimet tjera për shkelje të të drejtave kushtetuese*

26. Parashtruesja e kërkesës, përveç pretendimit të mësipërm, ajo gjithashtu pretendon se i është shkelur edhe neni 24 i Kushtetutës, sepse Gjykata Supreme ka refuzuar të shqyrtojë pretendimet e saj të ngritura nëpërmjet kërkesës për revizion, duke vërtetuar vetëm pretendimet e palës së paditur. Po ashtu parashtruesja e kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta shkelën edhe të drejtat e saj të garantuara me nenet 32, 49 dhe 54 të Kushtetutës, si rezultat i refuzimit të shqyrtimit të padisë në merita, që ka rezultuar nga aplikimi i gabuar i dispozitave të procedurës kontestimore dhe i së drejtës materiale. Në lidhje me këto pretendime parashtruesja e kërkesës vetëm i ka përkrahur nenet përkatëse, duke e ndërlidhur shkeljen e tyre me rregullsinë e procesit të zhvilluar ndaj saj.

Dispozitat relevante

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 24

[Barazia para Ligjit]

1. *Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
[...]

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. *Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
2. *Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*
[...]

Neni 32

[E Drejta për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj

Neni 49

[E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]

1. *E drejta e punës garantohet.*
2. *Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.*

Neni 54

[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

- 1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.*
- 2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.*

[...]

Ligji nr. 03/212 i Punës

Neni 78

Mbrojtja e të drejtave për të punësuarit

- 1. I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura.*
- 2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimin të kërkesës.*
- 3. Vendimi nga paragrafi 2. i këtij neni, i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej tetë (8) ditësh.*

Neni 79

Mbrojtja e të punësuarit në Gjykatë

Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente.

Ligji nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore

Neni 144

144.1 Gjykata mund ta urdhërojë palën e paditur që ta përmbushë premtimin e caktuar vetëm po që se kërkesa e paditësit është bërë e realizueshme para se të përfundojë shqyrtimi kryesor i çështjes.

[...]

144.3 Po që se premtimi që është objekt i kërkesëpadisë nuk është bërë i kërkueshëm deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, gjykata e refuzon kërkesëpadinë si të parakohshme.

Pranueshmëria e kërkesës

27. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

Neni 113

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

29. Gjykata gjithashtu më tej i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç specifikohen më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesja e kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

30. Sa i përket përmbushjes së kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar dhe se e njëjta konteston Aktgjykimin [Rev.nr. 340/2022] të 13 shtatorit 2022 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur nga autoritetet publike, në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtueshmëri me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
31. Përveç kriterëve të lartcekura, Gjykata shqyrton po ashtu nëse kërkesa i përmbushë kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht nënregullin (2), të Rregullores së punës, që përcakton:

Rregulli 34

[Kriteret e pranueshmërisë]

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

32. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të vet Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkritazi me ndonjë pretendim specifik që ajo mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”; (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNj-së (shih, rastin e GjEDNj-së [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqes Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih, rastin e Gjykatës [KI166/20](#), parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43); dhe në fund, (iv) pretendime “*konfuzë dhe të paqarta*” (shih, rastet e GjEDNj-së, [Kemmache kundër Francës](#), nr. 17621/91, Aktgjykimi i 24 nëntorit 1994, kategoria (i), [Juta Mentzen kundër Lituanisë](#), nr. 71074/01, vendimi i 7 dhjetorit 2004, kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii)).
33. Fillimisht, Gjykata rikujton se sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNj), një ankesë karakterizohet nga faktet e përfshira në të, dhe jo vetëm nga baza ligjore dhe argumentet në të cilat palët thirren shprehimisht (Shih, në këtë kuptim rastin e GjEDNj-së: [Talpis kundër Italisë](#), nr. 41237/14, Aktgjykimi i 18 shtatorit 2017, paragrafi 77 dhe referencat e cituara aty).
34. Në vazhdim, Gjykata, rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, në ndërlidhje me vendimet e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Themelore, shkel të drejtat e saj të garantuara me nenet 24, 31, 32, 49 dhe 54 të Kushtetutës.
35. Referuar shkresave të lëndës, Gjykata vëren se esenca e ankesës që ngërthen kërkesa e parashtrueses së kërkesës, ka të bëjë veçanërisht me parregullsinë e procesit respektivisht me të drejtën për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm KEDNj).
36. Andaj, pretendimin thelbësor të parashtrueses së kërkesës, Gjykata do e shqyrtojë dhe analizojë nga pikëpamja e të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në dritën e interpretimit të nenit 6.1 të KEDNj-së, duke aplikuar parimet e përcaktuara nga GjEDNj-ja, në bazë të së cilave kjo Gjykatë dhe gjykatat e rregullta në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës janë të

obliguara që: “Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

I. Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës

37. Gjykata vëren se thelbi i ankesës së parashtrueses së kërkesës ndërlidhet me faktin se gjykatat e rregullta në mënyrë të gabuar kanë vërtetuar faktet e rastit dhe në mënyrë të gabuar kanë aplikuar dispozitat e Ligjit të punës dhe të LPK-së, kur kanë vendosur për hedhjen e padisë së saj si të parakohshme. Në të vërtetë i gjithë arsyetimi i shkeljes së të drejtës për gjykim të drejtë, si kundër edhe i neneve tjera të sipërcekura nga parashtruesja e kërkesës është ndërtuar në kuadër të pretendimeve të natyrës së “shkallës së katërt”.
38. Prandaj, në vazhdim Gjykata do i shtjellojë parimet e përgjithshme të përcaktuara nga GjEDNj, nëpërmjet të cilave saktësohet nëse një pretendim i ngritur nga parashtruesit e kërkesës bie në fushëveprimin e paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNj-së, apo i takon pretendimeve që në vetvete ngrenë çështje ligjshmërie, respektivisht çështje të “shkallës së katërt”.
- a) *Parimet e përgjithshme përkitazi me pretendimet e “shkallës së katërt”*
39. Gjykata duke iu referuar praktikës gjyqësore të GjEDNj-së dhe të saj, përsërit se sipas Kushtetutës nuk është detyrë e saj si Gjykatë Kushtetuese të veprojë si “shkallë e katërt” përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është roli i këtyre të fundit që t’i interpretojnë dhe zbatojnë dispozitat përkatëse të së drejtës materiale dhe procedurale (shih, në lidhje me këtë rastin e GjEDNj-së, [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999). Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi/ja të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, rastin e GjEDNj-së, [Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 13071/87; dhe rastin e Gjykatës [KI192/13](#), me parashtrues *Hatixhe Avdyli*, Aktvendimi i 24 shkurtit 2014).
40. Gjykata në mënyrë konsistente ka mbajtur qëndrimin se nuk është detyrë e saj si Gjykatë që të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta, përveç nëse ato i kanë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNj. Andaj, Gjykata nuk duhet të veprojë si gjykatë e “shkallës së katërt”, kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Çështjet që lidhen me vlerësimin e provave dhe peshimin e tyre nga ana e gjykatave e rregullta, nuk janë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese që të rishikohen (Shih, rastin e GjEDNj-së, [Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), Aktgjykim i 29 nëntorit 2016; dhe rastin e Gjykatës [KI70/11](#), me parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima, Bestar Hima*, Aktvendimi i 12 dhjetorit 2011).
41. Gjykata, megjithatë, thekson se jurisprudenca e GJEDNj-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. Siç u theksua më lart, përderisa gjykatat e rregullta kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të ligjit të aplikueshëm, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë kompatible me Kushtetutën dhe KEDNj-në (Shih, në këtë drejtim, rastin e GJEDNj-së, [Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës](#), Aktgjykim i 25 majit 2000.). Në parim, një përjashtim i tillë ndërlidhet me rastet të cilat rezultojnë të jenë dukshëm arbitrare, duke përfshirë ato në të cilat, një gjykatë ka “*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*”,

në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “qartazi të paarsyeshme” për parashtruesin përkatës.

42. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale (shih rastin e Gjykatës [KI49/19](#), me parashtrues *Limak Kosovo International Airport S.H.A.*, “*Adem Jashari*”, Aktvendimi i 10 shtatorit 2019, dhe [KIo8/23](#), cituar më lart, paragrafi 35).
43. Gjykata, si rregull ka theksuar që ajo nuk mund të vë në dyshim gjetjet e gjykatave të rregullta që kanë të bëjnë me: (i) vërtetimin e fakteve të rastit; (ii) interpretimin dhe zbatimin e ligjit; (iii) pranueshmërinë dhe vlerësimin e provave në gjykim; (iv) drejtësinë substanciale të rezultatit të një kontesti civil; apo edhe (v) fajin ose pafajësinë e të akuzuarit në procedurën penale.
44. Gjykata rikujton se neni 31 i Kushtetutës nuk i garanton askujt rezultat të favorshëm në një proces gjyqësor dhe as nuk përcakton që Gjykata ta vë në diskutim zbatimin e së drejtës materiale nga gjykatat e rregullta në një kontest civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb. Gjykata, gjithashtu thekson se pakënaqësia e parashtrueses së kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund të ngrejë vetvetiu pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (Shih rastin e GjEDNj-së, [Mezotur-Tiszazuqi Tarsulat kundër Hungarisë](#), Aktgjykim i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; rastin e Gjykatës [KI96/21](#), parashtrues *Xhelal Zherka*, Aktvendim i 10 shtatorit 2021).

b) Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

45. Duke iu referuar pretendimit thelbësor të parashtrueses së kërkesës, Gjykata vëren se argumenti kryesor i saj i ngritur në kërkesë është se gjykatat e rregullta në mënyrë të gabuar vërtetuan faktet kur konstatuan se padia e saj ishte e parakohshme, dhe në këtë mënyrë ato vepruan në kundërshtim me dispozitat përkatëse të ligjit materiale dhe procedural, duke shtuar se sipas nenit 144 të LPK-së padia është dashur të shqyrtohej meritorisht dhe jo të hidhej poshtë si e parakohshme.
46. Në lidhje me këtë pretendim dhe shikuar procedurat në tërësinë e tyre, në kuptim të rregullsisë së procesit gjyqësor, Gjykata fillimisht i referohet Aktvendimit të Gjykatës Themelore, e cila arsyetoi se: “...padiësi (padiësja) ka pasur të drejtë ligjore që në mënyrë të lirshme të ushtrojë mjetet juridikë, qoftë brenda të paditurës, qoftë edhe në rrugë gjyqësore (nëse nuk kishte marrë përgjigje nga e paditura), mirëpo përdorimi i këtyre mjeteve juridikë është dashur të bëhet brenda afateve ligjore të përcaktuara. Andaj, mos shfrytëzimi i këtyre mjeteve juridikë, brenda afateve të caktuara (afate prekluzive), ka si pasojë edhe humbjen të drejtës për mbrojtje gjyqësore dhe jo për shkak se kjo e drejtë i është mohuar padiësit, por për shkak se ky i fundit ka dështuar që më kohë t’i shfrytëzoj këto mjete juridikë të cilat i ka pasur në dispozicion ...”
47. Gjykata vëren se gjendja faktike e vërtetuar nga Gjykata Themelore është pranuar në tërësi edhe nga Gjykata e Apelit, e cila në Aktvendimin e saj [AC.nr.8041/21] të 31 majit 2022, arsyetoi se, Gjykata Themelore, duke vepruar sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit, ka vërtetuar tashmë faktin se padia në gjykatën e shkallës së parë ishte ushtruar, para se padiësja t’i drejtohej organit përkatës të punëdhënësit, respektivisht para se t’i shfrytëzonte mjetet e brendshme juridike, dukës shtuar se aq me tepër ku padiësja ishte e përfaqësuar nga avokati i saj, në të gjitha proceset relevante, që nga 3 tetori 2013 e tutje. Në këtë kuptim, Gjykata e Apelit, arsyetoi se gjykata e shkallës së parë ishte udhëzuar me Aktvendimin e saj [CA.nr.1322/2016], të 9 nëntorit 2018, që të vërtetojë

respektimin e aspekteve procedurale të përcaktuara me dispozitat e nenit 78 dhe 79 të Ligjit të Punës, dhe se gjykata e shkallës së parë në procedurën e rigjyimit, bazuar në këto rekomandime ka vërtetuar më të drejtë se padia e paditëses ishte e parakohshme.

48. Për më tepër, Gjykata verën se në linjë me konkluzionet e Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit, ishte edhe Gjykata Supreme, e cila, mes tjerash, arsyetoi se qëndrimet juridike të instancave me të ulëta janë të pranueshme dhe të drejta, sepse të njëjtat duke zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe dispozitat e së drejtës materiale kanë vendosur drejtë se padia e paditëses është e parakohshme. Tutje në arsyetim theksohet se Aktvendimi i goditur me revizion nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore edhe as me shkelje të së drejtës materiale, siç pretendohet në kërkesën për revizion dhe as me shkelje tjera për të cilat kjo gjykatë kujdese, sipas detyre zyrtare.
49. Në fund, Gjykata Supreme, arsyetoi se gjykatat e instancës me të ulët, kanë zbatuar drejtë dispozitat e nenit 78 dhe 79 të Ligjit të Punës. Në lidhje me këtë rast, Gjykata Supreme konstatoi se paditësja, gjegjësisht parashtruesja e kërkesës nuk ka vepruar në përputhje me këto dispozita dhe kjo ka bërë që gjykatat e instancës me të ulët, në mbështetje të nenit 71 paragrafit 1 dhe 2, të nenit 79, dhe të nenit 391, pika f) të vendosin si në dispozitiv të aktvendimit.
50. Sa me sipër, Gjykata vlerëson se parashtruesja e kërkesës në të vërtetë nuk ka arritur të ngrejë nivelin e argumentimit të shkeljeve të pretenduara në nivel kushtetues, duke aluduar se në vend të një norme ligjore do duhej aplikuar një tjetër, në rastin e saj. Nga arsyetimi i dhënë nga gjykatat e rregullta, parashtrueses së kërkesës i është bërë e qartë se për të kërkuar mbrojtje gjyqësore në gjykatë, sipas ligjit të aplikueshëm, kundër shkeljeve nga sfera e të drejtave të punës, duhet përmbushur disa kritere procedurale, siç është ai i shterimit të mjeteve të brendshme juridike, brenda afateve kohore, në mënyrë që padia të behej e realizueshme në kuptim të shqyrtimit të meritave të saj.
51. Duke pasur përsysh këtë, Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk ka arritur ta mbështes mjaftueshëm pretendimin e saj për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, sepse bazuar në parimet e lartcekura dhe në konkluzionet e arsyetuara të gjykatave të rregullta, në rastin konkret nuk është përmbushur kriteri përjashtues, kur interpretimi i ligjit të aplikueshëm nga ana e gjykatave të rregullta mund të ketë qenë “qartazi i gabuar”, duke rezultuar kështu në “konkluzione arbitrare” apo “qartazi të paarsyeshme” apo se si procedurat pranë gjykatave të rregullta, në tërësinë e tyre, mund të kenë qenë të padrejta apo arbitrare. (Shih ngjashëm rastin GjEDNJ-së, [García Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafët 29 dhe 30; shih gjithashtu rastet e Gjykatës [KI22/19](#), parashtrues [Sabit Ilazi](#), Aktvendim për papranueshmëri i 7 qershorit 2019, paragrafi 42; [KI64/20](#), parashtrues [Asllan Meka](#), Aktvendim për papranueshmëri, i 3 gushtit 2020, paragrafi 41; dhe [KI22/19](#), cituar më lart, paragrafi 43).
52. Andaj, nga të gjitha shtjellimet e mësipërme, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtrueses së kërkesës për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, i takojnë kategorisë së parë (i) të pretendimeve që kategorizohen si pretendime të natyrës së “shkallës së katërt”, dhe si të tilla të njëjtat, në baza kushtetuese, shpallen qartazi të pabazuara.

II. Përkitazi me pretendimet tjera

53. Gjykata rikujton se përveç pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, parashtruesja e kërkesës pretendon edhe shkelje të neneve 24, 32, 49 dhe 54 të Kushtetutës. Megjithatë, Gjykata rithekson se ajo vazhdimisht ka potencuar se vetëm

referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së, ose ndërlihdja e tyre me ndonjë të drejte tjetër të Kushtetutës, nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje të atyre neneve specifike. Kur pretendohen shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, parashtruesi/ja i/e kërkesës duhet të siguroj pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (Shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës: KI175/20, me parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 prillit 2021, paragrafi 81; KI04/21, me parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 majit 2021, paragrafët 38-39, dhe rastin KI139/22, cituar me lart, paragrafi 86).

54. Për këto arsye, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtrueses së kërkesës për shkelje të neneve 24, 32, 49 dhe 54 të Kushtetutës, i përkasin kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a), të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj të njëjtat në baza kushtetuese shpallen qartazi të pabazuara.

Përfundime

55. Si përmbledhje, Gjykata, duke i marrë parasysh të gjitha shtjellimet dhe konstatimet e mësipërme, konkludon se: (I) pretendimet e parashtrueses së kërkesës, përkitazi me shkeljen e të drejtës për *gjykim të drejtë*, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, i takojnë kategorisë së parë (i) të pretendimeve që kategorizohen si pretendime të natyrës së “*shkallës së katërt*”, dhe si të tilla të njëjtat, në baza kushtetuese, shpallen qartazi të pabazuara; (II) pretendimet e parashtrueses së kërkesës, përkitazi me shkeljet tjera të të drejtave kushtetuese, bien në kategorinë e tretë (iii), nënkategorinë a), të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj edhe këto, në baza kushtetuese, shpallen qartazi të pabazuara. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësinë e saj, duhet shpallur e papranueshme, në pajtim me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, në pajtim me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 34 (2) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur, më 14 nëntor 2023, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 20.5 të Ligjit.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani